

BASHKËPUNIMI I AGJENCISË SHTETËRORE TË ARKIVAVE TË KOSOVËS ME ARKIVAT NË RAJON PAS VITIT 1999

Abstrakt: *Fatmirësisht në shumë vende është në rritje interesimi për bashkëpunim në mes të arkivave, bibliotekave dhe muzeve. Bashkëpunimi në mes të institucioneve të ndryshme sidomos ai në mes të arkivave është i një rëndësie të veçantë, pasi u ofron njerëzve qasje më të lehtë dhe më të shpejtë në trashëgiminë kulturore. Andaj, kjo kumtesë në vete paraqet Marrëveshjet e Bashkëpunimit të ASHLAK-së pas vitit 1999, të cilat i ka të nënshkruara me Arkivat e Rajonit. Veçanërisht trajton format dhe mënyrat e bashkëpunimit të ndërsjellë në mes të institucioneve të lartpërmendura.*

Vendosja e marrëdhënieve të bashkëpunimit të ndërsjellë me arkivat të tjera kërkon dhe objektivisht kontribuon në mënyrë të konsiderueshme në suksesin dhe cilësinë e qëllimeve dhe objektivave të çdo arkivi. Përveç pasurimit të fondeve arkivore, shkëmbimit të literaturës, ekspertëve e përvojave, të cilat kryesisht janë pika kyçe në Marrëveshjet e Bashkëpunimit, po ashtu duhet theksuar se njëri ndër qëllimet kryesore të bashkëpunimit të arkivave është që t'u ofrojmë njerëzve mundësinë për të hulumtuar arkivat me procedura më të thjeshta dhe më të lehta.

Fjalët kyçe: *Bashkëpunimi, Marrëveshjet e Bashkëpunimit, Arkivat e Rajonit, pasurimi i fondeve.*

COOPERATION OF THE STATE AGENCY OF KOSOVO ARCHIVES WITH REGIONAL ARCHIVES AFTER 1999

Abstract: *Fortunately, in many countries, there is a growing interest in cooperation among archives, libraries and museums. Co-operation between different institutions especially those between archives, is of particular importance, as it provides people with easier and faster access to cultural heritage. Therefore, this paper presents Cooperation Agreements of SAKA after 1999 signed with the Regional Archives. In particular, it deals with the forms and methods of cooperation between these institutions.*

Establishing relationships of mutual cooperation with other archives requires and

contributes significantly to the success and quality of the goals and objectives of each archive. In addition to enriching archival fonds, exchanging of literature, experts and experiences, which are mainly key points in Cooperation Agreements, it should also be noted that one of the main purposes of archival collaboration is to provide people with the opportunity to research archives with simpler and easier procedures.

Key words: *Cooperation, Cooperation Agreements, Regional Archives, enrichment of archival fonds.*

Hyrje

Në shumë vende të botës Arkivat shihen si një nga shtyllat ku mbështetet një shtet demokratik, gjë që ka rritur ndjeshëm vëmendjen ndaj tyre. Ndër detyrat themelore të arkivit është edhe zhvillimi i bashkëpunimit ndërarkivor dhe ndërkombëtar, që cilësohet të jetë mjaftë i rëndësishëm për veprimtarinë arkivore. Periudha të cilës i referohet kumtesa kryesisht paraqet marrëdhëniet e bashkëpunimit të ASHAK-së me arkivat tjera.

Fillimisht do të paraqesim të dhëna të rëndësishme që kanë të bëjnë me institucionalizimin e shërbimit arkivor në Kosovë, i cili fillon tek pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, përkatësisht në vitin 1948, ku formohet Qendra Arkivore në kuadër të Drejtoratit Krahinor për Arsim dhe Kulturë, e cila për mision kishte mbrojtjen dhe evidentimin e lëndës arkivore.

Ndërsa, më 20 mars 1951 me Vendimin e Këshillit Krahinor themelohet Arkivi Shtetëror Krahinor i Kosovës dhe me këtë fillon edhe funksionimi i shërbimit arkivor në Kosovë. Pas suprimimit të autonomisë së Kosovës dhe vendosjes së masave të dhunshme sikurse në të gjitha institucionet vendore edhe Arkivi i Kosovës administrohet nga këto masa të dhunshme. Ndërsa, pas mbarimit të luftës së fundit në Kosovë (vitet 1998-1999), sikurse edhe veprimtaritë tjera, edhe shërbimi arkivor pësoi ndryshime pozitive.

Vendosja e marrëdhënieve të bashkëpunimit pas vitit 1999

Sikurse në çdo vend tjetër të dalë nga lufta edhe në Kosovë filloi një periudhë e re e zhvillimit dhe shtet ndërtimit për të gjitha institucionet e Kosovës, e po ashtu edhe për Arkivin e Kosovës.

Paslufta e gjeti Arkivin e Kosovës në kushte të vështira. Fillimisht, krahas shumë nevojave imediate për zhvillimin e Arkivit të Kosovës, duke filluar me mbledhjen e lëndës arkivore me qëllim të shpëtimit, mbrojtjen, klasifikimin, rregullimin, sistemimin dhe dhënien në shfrytëzim të lëndës arkivore, ku rëndësi e veçantë iu kushtua edhe anëtarësimit të Arkivit të Kosovës në organizatat relevante ndërkombëtare arkivore si dhe vendosjes së marrëdhënieve të

bashkëpunimit me arkivat rajonale.

Pa dyshim se ishte më se e domosdoshme që të ristrukturohej bashkëpunimi i mëparshëm me arkivat e tjera në rajon dhe të ri vendoseshin forma të reja të bashkëpunimit dypalësh. Kur flasim për rajonin të cilit i përkasim mund të themi se ka shumë arsye për krijimin dhe zhvillimin e bashkëpunimit ndërmjet arkivave. Shekuj me radhë në këtë pjesë kanë ndodhur shumë ngjarje intensive historike, ku nga gjitha këto zhvillime pa dyshim është krijuar një sasi e madhe e lëndës arkivore me shumë vlerë për historinë e Kosovës, pra materiali i cili dikur u krijua tek ne, por në rrethana të caktuara përfundoi në arkiva të tjera, ose është krijuar në shtetet tjera dhe ka të bëjë me vendin tonë.

Duke pasur parasysh lidhjet historike të ndërthurura, fillimisht janë rikthyer marrëdhëniet me shërbimin arkivor të fqinjëve më të afërt, si dhe me ata që e mbështetën Republikën e Kosovës në momentet e vështira të ekzistencës dhe forcimin e integritetit të saj.

Tashmë të gjithë e dimë dhe jemi të vetëdijshëm se subjekti i interesit dhe vëmendjes së arkivit është materiali arkivor me rëndësi për shkencën dhe kulturën. Rëndësi e posaçme i kushtohet materialit arkivor që ka të bëjë me Kosovën dhe gjendet në arkivat e tjera, pra materiali i cili dikur u krijua tek ne, por në rrethana të caktuara përfundoi në arkiva të tjera, ose është krijuar në shtetet tjera dhe ka të bëjë me vendin tonë.

Përmes bashkëpunimit me arkivat e tjera krijohet mundësia për grumbullimin e informacioneve për lëndën arkivore e cila është me rëndësi për vendin tonë, mirëpo gjendet në këto arkiva. Kjo gjithashtu nënkupton që edhe ne të ofrojmë një informacion të tillë, në lidhje me materialin që ndodhet në arkivat tona dhe ka rëndësi për vendet e tjera.

Brenga për lëndën arkivore nuk është i vetmi qëllim. E gjithë kjo qëllim final ka krijimin e kushteve dhe mundësive që ky material të jetë në dispozicion dhe që të mund të përdoret nga të gjithë ata që kanë apo që do të kenë nevojë për të. Lidhur me këtë çështje, bashkëpunimi me arkivat tjera, në mënyrë të konsiderueshme i rrit dhe i zgjeron mundësitë.

Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, qysh prej vitit 2002 është pjesë e organizatës më të madhe ndërkombëtare në fushën e arkivistikës, dhe është anëtare me të drejta të plota e Këshillit Ndërkombëtar të Arkivave (ICA) dhe e degës evropiane të saj EURBICA, që veprojnë nën autoritetin e UNESCO-s. Si rezultat i këtij anëtarësimi në ICA dhe bashkëpunimit të mirëfilltë, Arkivi i Kosovës ka qenë pjesëmarrës në Kongreset dhe Konferencat e ICA-së në vende të ndryshme të botës, si në Marsejë, Vjenë, Abu Dhabi, Quebec, Kuala Lumpur, Malajzi; Maltë; Oslo, Rejkjavik dhe Seul.

Kur jemi të bashkëpunimi ndërkombëtar mund të themi se Agjencia

Shtetërore e Arkivave të Kosovës i kushtoi rëndësi të veçantë vendosjes së marrëdhënieve në mes të arkivave të rajonit, ku falë angazhimit dhe përkushtimit të pa lodhshëm ka të nënshkuara Marrëveshje të Bashkëpunimit me disa arkiva të rajonit. Të gjitha këto marrëveshje janë shumë të ngjashme në përmbajtje, por paraqesin vetëm një bazë formale dhe përcaktojnë parimet themelore mbi të cilat do të bazohet bashkëpunimi. Bashkëpunimi bilateral i Arkivit të Kosovës lehtësoi shkëmbimin e përvojave, shkëmbimin e burimeve shkencore dhe informative, hulumtimin dhe shkëmbimin e dokumenteve, duke botuar botime të veçanta dhe të përbashkëta, duke organizuar takime profesionale dhe shkencore, duke organizuar dhe shkëmbyer ekspozita me dokumente arkivore, ndihmë në trajnimin e stafit profesional etj.

Menjëherë pas përfundimit të luftës Arkivi i Kosovës filloi hapat e parë të bashkëpunimit të ndërsjellë me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave të Shqipërisë, duke lidhur marrëveshje bashkëpunimi. Ky bashkëpunim dita ditës natyrshëm po zgjerohet, ku si rezultat është edhe organizimi i Konferencës së përbashkët Mbarëkombëtare. Falë këtij bashkëpunimi të mirëfilltë me DPA-në deri më tani janë realizuar shumë aktivitete si:

- Shkëmbimi i lëndës arkivore,
- Organizimi i Ekspozitave të përbashkëta;
- Shkëmbimi i përvojave dhe ekspertëve;
- Trajnimi i arkivistëve;
- “Botime të përbashkëta;
- Nxjerrja e Revistës së përbashkët arkivore “Arkivat Shqiptare”;

Ekspozitat e hapura në bashkëpunim me DPA janë:

- “Jeronim De Rada në dorëshkrime”;
- “Milan Shuflaj për shqiptarët”;
- “Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”;
- “Sami Frashëri dhe veprimtaria e tij”;
- “Anglo-amerikanët në Shqipëri e Kosovë 1943-1945”;
- “Kodikët e Shqipërisë”;
- “Dokumente nga Arkivat Shqipëri- Kosovë”.

Bashkëpunim mjaft konkret e frytdhënës ASHAK ka edhe me Drejtorinë e Përgjithshme të arkivave të Turqisë, që nga nënshkrimi i marrëveshjes në vitin 2005.

Menjëherë pas nënshkrimit të Protokollit të Bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës dhe Drejtorisë së Arkivave Shtetërore pranë Kryeministrisë së Republikës së Turqisë, filloi implementimi i

kësaj marrëveshjeje. Siç theksuam edhe më lartë një ndër format më të theksuara të këtij bashkëpunimi ishin hulumtimet dhe sjellja e dokumenteve arkivore nga arkivat e Republikës së Turqisë që flasin për të kaluarën e Kosovës. Bashkëpunimi rezultoi edhe me pjesëmarrjen e zyrtarëve të ASHAK-së në shumë Konferenca e Simpoziume Ndërkombëtare ku nikoqir ishte Arkivi i Turqisë. Po ashtu, vlen të theksohet edhe organizimi i Simpoziumit Ndërkombëtar “Kosova dhe Perandoria Osmane në dokumentet arkivore”, mbajtur në Prishtinë në vitin 2009. Si rezultat i bashkëpunimit zyrtarët e digjitalizimit realizuan një trajnim në Arkivin Shtetëror të Turqisë për metodat dhe format e digjitalizimit.

Arkivi i Kosovës përfitoi shumë nga ky bashkëpunim ku u pasurua me mbi 100 mijë dokumente arkivore me vlerë historike të cilat kanë të bëjnë për Kosovën. Në kuadër të bashkëpunimit herë pas here janë organizuar edhe Ekspozita të përbashkëta si: “Vilajeti i Kosovës në dokumente arkivore”; “Dokumente për Kosovën nga Arkivat Shtetërore të Turqisë”, etj.

Duke iu falënderuar këtij Bashkëpunimi, Arkivi Shtetëror i Republikës së Turqisë ka dërguar një ekspert-osmanolog për mbajtjen e kursit të osmanishtes në Arkivin e Kosovës. Të gjithë e dimë se rrethanat historike në të cilat është gjetur Kosova në periudha të caktuara kohore pa harruar periudhën e Sundimit të Perandorisë Osmane, ka bërë që të krijohet një numër i madh i dokumenteve në Kosovë dhe për të. Mësimi dhe deshifrimi i dokumenteve në gjuhën osmane ka një rol të rëndësishëm për historinë e Kosovës, andaj edhe mbajtja e kursit të osmanishtes ka qenë më se i domosdoshëm. Bashkëpunimi me Arkivat e Turqisë ka bërë të mundur edhe lehtësimin e qytetarëve për tu pajisur me Tapi të kohës së Perandorisë Osmane, pasi që të gjitha Tapitë e Vilajetit të Kosovës në formën digjitale i janë dorëzuar ASHAK-së dhe tashmë qytetarët nuk kanë nevojë të shkojnë në Turqi për një shërbim të tillë, por atë mund ta realizojnë këtë shërbim në Prishtinë.

Duke vazhduar me synimin e njëjtë ASHAK ka lidhur Marrëveshje Bashkëpunimi edhe me Arkivin e Republikës së Maqedonisë. Edhe kjo Marrëveshje Bashkëpunim sikurse të tjerat rezultoi me shkëmbim të dokumenteve arkivore, ekspozita të përbashkëta dhe vizita profesionale. Gjatë kësaj periudhe kohore ASHAK pasuroi fondet e dokumenteve me mbi 4 mijë dokumente (fotokopje), dokumente të cilat kanë të bëjnë për Kosovën, u hap Ekspozita “Maqedonia ndër shekuj”, si dhe u bë promovimi i librit të Qerim Litës *Politika e Mbretërisë Jugosllave ndaj shqiptarëve (1929-1940)*, i cili ishte botim i përbashkët i dy institucioneve.

Falë bashkëpunimit të ndërsjellë, ASHAK i dhuroi Arkivit të Maqedonisë në formën digjitale komplet fondin arkivor “Jovan Jovanoviq-Pizhon” .

Vendosja e marrëdhënieve të bashkëpunimit me Arkivin e Republikës së

Kroacisë, gjithashtu në vete përmban rezultate të mira, duke filluar me pjesëmarrje në Konferenca, si dhe në hulumtimin dhe pasurimin e fondeve arkivore, nga ku janë sjellë një numër i konsiderueshëm i dokumenteve arkivore, Po ashtu, në kuadër të aktiviteteve të zhvilluara u bë hapja e Ekspozitës së përbashkët “Arkivat Shtetërore në Kroaci”.

Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Agjencinë e Arkivave Shtetërore të Bullgarisë gjithashtu vlerësohet të jetë një bashkëpunim profesional dhe miqësor, i cili rezultoi me vizita profesionale, hulumtime arkivore, trajnim të kuadrit arkivor në restaurim dhe konservim, si dhe me hapjen e Ekspozitës së përbashkët “Kosova dhe Bullgaria në harta”. Nga marrëveshja në fjalë u realizuan hulumtimet arkivore në Arkivin Ushtarak në Veliko Tërnovo të Bullgarisë, nga ku janë sjellë një numër i konsiderueshëm i dokumente, që kanë të bëjnë për Kosovën.

Duke marrë parasysh rëndësinë që kanë arkivat e Austrisë me dokumentacion të rëndësishëm të krijuar për zhvillimet në Kosovë, ASHAK në vitin 2011 arriti të vendos bashkëpunim me Arkivin Shtetëror të Austrisë. Falë këtij bashkëpunimi u zhvilluan hulumtime arkivore në Arkivin e Luftës nga ku u sollën një numër i konsideruar i dokumenteve digjitale që kanë të bëjnë për Kosovën gjatë Luftës së Parë Botërore.

Krahas përkushtimit në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve të caktuara, ASHAK vazhdoi me përkushtim vendosjen e marrëdhënieve të bashkëpunimit, ku në vitin 2016 nënshkroi Marrëveshje të tillë me Arkivin Shtetëror të Malit të Zi .

Edhe pse me Arkivin e Sllovenisë, me atë të Bosnjës dhe Hercegovinë nuk kemi marrëveshje të bashkëpunimit të nënshkruara asnjëherë nuk ka mundur bashkëpunimi. Këtë më së miri e dokumenton pjesëmarrja e rregullt e zyrtarëve arkivor si ligjërues në Konferenca vjetore Ndërkombëtare si në Radenci të Sllovenisë, në ICARUS- Kroaci, në Tuzëll të Bosnjës, në Trieste të Italisë, etj. Në këtë frymë ASHAK në pamundësi që të dërgoj arkivistët jashtë vendit për trajnim herë pas here ka organizuar trajnime brenda vendit me ligjërues profesionist nga arkivat rajonit.

Falë bashkëpunimit, këmbënguljes dhe përkushtimit në pasurimin e fondeve arkivore ASHAK gjithmonë kërkoi dhe hapi shtigje të reja, madje tejkaloi edhe oqeanet për të pasuruar fondet dhe koleksionet arkivore. Duke iu falënderuar mbështetjes së miqve të Kosovës, zyrtarë të ASHAK-së udhëtuan për SHBA nga ku sollën dokumentacionin e “Lidhjes së Tretë të Prizrenit” dhe dokumentet e Komitetit “Shqipëria e lirë”. Këto dokumente deri më tani janë të pa para nga publiku i gjerë, andaj duke ditur vlerën dhe rëndësinë e tyre

konsiderohen si fonde të veçanta, të cilat po ashtu kërkojnë trajtim të veçantë.

Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës gjithmonë ka qenë e përkushtuar për thellim të bashkëpunimit, andaj për të arritur këtë qëllim me rastin e 65 vjetorit të Themelimit të Arkivave të Kosovës ka organizuar Konferencën “Sfidat e bashkëpunimit me Arkivat e Rajonit”, me që rast pjesëmarrës të Konferencës ishin përfaqësuesit e Arkivave të Shqipërisë, Turqisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi.

Në vazhdimësi ASHAK është e përkushtuar që ta thellojë dhe zgjerojë bashkëpunimin si me arkivat me të cilat ka Marrëveshje të nënshkruara, e po ashtu edhe me Arkivat tjera.

Aktivitetet e realizuara të cilat i prezantuan në këtë punim janë një dëshmi e mirë se marrëdhëniet e bashkëpunimit në mes të ASHAK-së dhe disa Arkiva të Rajonit janë shumë të mira dhe në vazhdimësi janë duke u forcuar. Besojmë që në një të ardhme të afërt të lidhim Marrëveshje Bashkëpunimi edhe me Arkivat tjera të rajonit dhe të botës, pasi që bashkëpunimi është shumë i rëndësishëm si për ne ashtu edhe për arkivat e vendeve fqinje me të cilat kemi lidhje të thella dhe të pa shkëputura kulturore.

Bibliografi:

Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës. *Marrëveshja e Bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave të Shqipërisë*, Nr. 01/350/14, 04.12.2014.

Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës. *Marrëveshja e Bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave Shtetërore të Republikës së Turqisë*, Nr. 01/338/14, 24.11.2014.

Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës. *Marrëveshja e Bashkëpunimit me Arkivin Shtetëror të Republikës së Maqedonisë*, Nr. 01/123/18, 14.05.2018.

Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës. *Marrëveshja e Bashkëpunimit me Arkivin Shtetëror të Malit të Zi*, Nr. 01/103/16, 22.03.2016.

Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës. *Marrëveshja e Bashkëpunimit me Arkivin Shtetëror të Bullgarisë*, Nr. 01/62/16, 15.02.2016.

Kuvendi i Kosovës. *Ligji për Arkivat Shtetërore*, Nr. 04/L-088, 19 mars 2012.

Sұлçevsi, Refike. *Hulumtimet arkivore në arkivat e Turqisë*. VJETAR. Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës. Prishtinë: 2010, Nr. 43-44.

